

**ALGERT KALICA**

**EMRAT E LËNDËS NË GRAMATIKA**

**Shkurtores**

Objekti i këtij studimi janë emrat e lëndës. Qëllimi është të njohim e të kuptojmë më mirë emrat e lëndës, që ta përcaktojmë drejt e ta veçojmë këtë klasë leksikore. Për këtë, studiuam gramatika të disa gjuhëve, mblodhëm, përpunuam dhe paraqitëm të dhënat. Emrat e lëndës përfshihen në klasën e emrave të panumërueshëm dhe ndonjëherë përkufizohen. Gramatikat ndalen në tipare gramatikore të tyre, si numri njëjës. Në disa raste, kur italishtja dhe frëngjishtja u vë pranë mjete analitike si *nyja përpjesore* apo parafjalët *de* dhe *en*, shqipja përdor mjete sintetike si mbaresat e pashquarësisë apo ato të rasës rrjedhore. Emrat e lëndës kanë mundësi të përcaktohen nga fjalë që tregojnë një sasi të pacaktuar, si përemrat e pacaktuar. Një pjesë e madhe e parafjalëve që shkojnë me emrat e lëndës, shkojnë edhe me emrat e numërueshëm. Mbiemri marrëdhënior mund të shprehë një marrëdhënie lëndore, njëlloj si rasat e zhdrejta të emrit të lëndës. Ky studim paraqet një tablo të kthjellët të veçorive gramatikore të emrave të lëndës që shfaqen në gramatika. Nga ana tjetër, nxjerr në pah se gramatikat nuk i trajtojnë sa duhet emrat e lëndës.

**Lista e shkurtesave**

BU – Bon Usage  
DDLDF – Dictionnaire des difficulties de la langue française  
EGUC – English grammar, university course  
OGEF – Oxford Guide to English Grammar  
GE – Grammatica essenziale  
GGJSH – Gramatika e gjuhës shqipe  
GI – Grammatica italiana – italiano comune e lingua letteraria  
GLFC – Grammaire Larousse du français contemporain

**Hyrje**

Për semantikën përshkruese është e rëndësishme të kryhet analiza përbërëse e fjalëve që i përkasin secilës klase leksikore. Por më parë, duhet veçuar klasa leksikore. Në kuptimin e përgjithshëm, emrat e lëndës janë ata që tregojnë lëndë. Por ky përkufizim nuk mjafton për të veçuar klasën leksikore të tyre. Përgjithësisht, njohuritë e para për nocionin emra të lëndës merren në gramatika; në të vërtetë, ato e trajtojnë pak a shumë dëndur këtë klasë leksikore. Prandaj, duke u kufizuar tek gjuhët që njohim, studiuam gramatika të gjuhëve shqipe, frënge, angleze, italiane. Gramatikat frënge i zgjodhëm nga reputacioni që gëzojnë. *Bon Usage* është cilësuar “gramatika më e mirë frënge” nga shkrimtari Andre Zhid (André Gide). Këtë e garantojnë edhe çmimet që autorët e saj kanë

marrë nga Akademia Mbretërore Belge dhe Akademia Frënge. Gramatika *Larousse* nuk mbetet pas: e tepërt të zgjatemi duke e mburrur. Përveç këtyre, shqyrtoam dhe një fjalor të përdorimit të “vështirësive të gjuhës frënge” që tregon përdorimin e saktë të fjalës a të shprehjes, me fjalë të tjera një fjalor gramatikor *Larousse*. Meqenëse për gjuhët angleze dhe italiane ka shumë gramatika të mira, që vlejnë pak a shumë njëllon, atëherë u merakosëm të gjejmë prej tyre që jepen mësim në universitete. *English Grammar a University Course*, siç tradhëton emri, jepet mësim në universitete midis të cilave në “*Universidad Complutense*”, Madrid. Ndërsa, *Oxford Guide to English Grammar* përveç prestigjit të emrit, është edhe botim universitar (shih bibliografinë). *Grammatica Italiana* jepet mësim në universitetin “*La Sapienza*”, Romë. Edhe *Gramatika e Gjuhës Shqipe 1* është dhënë dhe jepet mësim në universitetet shqiptare. Përveç këtyre, nga italishtja morëm edhe një gramatikë themelore të njohur. Hapi tjetër që analiza. Së pari kryem një lexim të tyre për të parë ku shfaqet emërtimi *emra të lëndës*, apo emërtime të përmbledhëse ku ata bëjnë pjesë, si *emra të panumërueshëm*. Më pas, u ndalëm kudo ku emrat e lëndës shfaqen, edhe kur shpjegohen rregulla a dukuri që nuk lidhen vetëm me emrat e lëndës, edhe kur merren si shembuj të rastësishëm. Paraqitja e tyre në këtë punim nuk ndjek rendin e shfaqjes së tyre në gramatika, por atë të përmbajtjes sipas temave që këtu përkojnë me tipare gramatikore e të tjera veçori të emrave të lëndës.

Qëllimi është të njohim e kuptojmë më mirë emrat e lëndës, të nxjerrim sa më shumë të jetë e mundur të dhëna rreth tyre. Kjo do të na ndihmojë të përcaktojmë e ta veçojmë klasën leksikore në mënyrë që pastaj t’u kryejmë analizën përbërëse njësisive leksikore përkatëse. Rëndësia e këtij punimi qëndron në këtë se do të paraqesim një tablo më të plotë të veçorive gramatikore të emrave të lëndës.

### 1. Emrat e lëndës si zë më vete

Thua jse tërë gramatikat përkufizojnë emrat e panumërueshëm; midis shembujve, japin edhe emra të lëndës. Kështu, BU (f. 584), midis “ndarjeve të emrave sipas kuptimit” rendit edhe kundërvënien *të numërueshëm - të panumërueshëm*: “Quhen emra të numërueshëm (*comptables* ou *nombrables*) emrat që mund të shoqërohen me numëror. *Këmbë* është i numërueshëm, *borë* është i panumërueshëm. Kundërvënien ka të bëjë më shumë me emrat konkretë”.

Pa humbur kohë tek kjo ndarje e gjerë, po vijojmë me dy gramatikat e vetme që i trajtojnë si zë më vete *emrat e lëndës*. Ato, japin edhe një përkufizim të tyre. Për më tepër, duke vepruar kështu do të kemi formuar edhe një ide të përgjithshme të trajtimit të tyre përpara se të shohim anë të veçanta të tyre që shfaqen aty këtu ndër gramatika.

Ja se ç’thuhet tek GGJSH (f. 87 - 88): “Në radhën e emrave të përgjithshëm që emërtojnë sende të panumërueshme, veç emrave abstraktë dhe përmbledhës, dallohen si grup më vete edhe *emrat e lëndës*. Nga shumë pikëpamje ata afrohen me emrat përmbledhës. Emrat e lëndës janë fjalë që emërtojnë një lëndë homogjene, mund të ndahet në pjesë dhe të peshohet, por që nuk mund të numërohet.

## Emrat e lëndës në gramatika

Nga kuptimi i tyre leksikor emrat e lëndës janë fjalë të ndryshme, që të emërtojnë: prodhime ushqimore, kultura bujqësore, metale e minerale, kimike etj.: *djathë, dhallë, gjizë, himë, hirrë, kos, mjaltë, qumësht, verë, duhan, elb, grurë, kashtë, të lashtat, li, thekër, alkool, benzinë, krom, qymyr, serë, squfur, vajguri, kartë, nailon, nitrat, superfosfat*. Emrat e lëndës përdoren vetëm në një numër; shumica kanë vetëm numrin e njëjësit dhe pak emra vetëm atë të shumësit. Sikurse emrat përmbledhës edhe këta s'kanë mundësi të përcaktohen nga një numëror duke përfshirë këtu edhe numërorin *një*, qoftë edhe me vlerën e emrit të pacaktuar. [...] Nga pikëpamja fjalëformuese emrat e lëndës [në shqip] në shumicën e tyre janë fjalë të parme. Fjalët jo të parme janë të pakta: kafeinë, të lashtat, manaferrë, qymyrguri, vajguri”.

Edhe EGUC i trajton veçmas emrat e lëndës: “Anglishtja na detyron të bëjmë një dallim nga mënyra sesi përkapet mendërisht një referent: si njësi e ndarë e numërueshme, p.sh. *lopë* (*cow*), apo si njësi e pandashme e panumërueshme mase lëndore, si “*mish lope*” (*beef*). Ky dallim përbën një tipar rëndësor në përvojën e folësve rreth sendeve. [Edhe] gjuhë të tjera bëjnë dallimin *emër i numërueshëm – emër lënde*, por nuk duhet aspak të kuptojmë se sende të ndryshme konceptohen dhe leksikalizohen njëllor në gjuhë të ndryshme. P.sh. *news* (*lajm*) është një emër lënde [në kuptimin i panumërueshëm] njëjës në anglisht (*the news is good - lajmi është i mirë*); *\*one news, \*a news, \*many news* janë jo-gramatikore. Përkundrazi, në spanjisht, *noticia* (*lajm*) është emër i numërueshëm<sup>1</sup>. Ne përdorim termin emër ‘i panumërueshëm’ dhe ‘emër lënde’ pa dallim, meqë të dy përdoren rëndom”. (EGUC f. 405) Nga ky pohim kuptojmë se hartuesit e gramatikës angleze e dinë se nga pikëpamja kuptimore emri i panumërueshëm nuk është doemos emër lënde. Megjithatë, meqenëse gramatikisht sillen njëllor, ata nuk i dallojnë këta dy emërtime, pra përdorin njërin në vend të tjetrit: këtë e pamë më lart (kur emrit të numërueshëm i kundërvënë emrin e lëndës dhe jo atë të panumërueshëm), do ta shohim edhe më tutje.

Më tutje, jepet edhe një përkufizim i emrave të panumërueshëm: “Emër i panumërueshëm është ai, referenti i të cilit perceptohet si i panumërueshëm. Nuk themi p.sh. *\*three furnitures (\*tri mobilje), \*one luggage (\*një bagazh)*. Të dyja këto (*furniture, luggage*) si dhe *news* mund të ndahen me një matës sasive ‘*a piece of*’ (një copë) siç do ta shohim më tutje”. (EGUC f. 406) Konstatimeve të gramatikës angleze ne u shtojmë edhe këtë: një emri lënde (të panumërueshëm) në anglisht nuk i gjejet doemos një emër lënde (i panumërueshëm) në shqip (a në tjetër gjuhë).

EGUC (f.406 - 408) i bën një ndarje në nënklasa emrave të panumërueshëm, ngaqë “janë problematikë për ata që mësojnë anglishten”. Nis me ndarjen njëjës – shumës, pastaj përmend emrat e panumërueshëm njëjës që kanë formën e pazakontë të shumësit, emra që s'i interesojnë punimit tonë, pasi nuk tregojnë substancë. Më pas kryhet një ndarje sipas kuptimit. Edhe këtu përmenden shumë

<sup>1</sup> Edhe në shqip, ndryshe nga anglishtja dhe njëllor si në spanjisht, emri *lajm* është i numërueshëm.

nënklasa, si “emra që i referohen një numri sendesh të konceptuara si një e tërë [...] emrat e disa sëmundjeve, e lojrave [...] emrat abstraktë [...] ata që tregojnë] veprimtari, [...] të ndryshëm”. Midis këtyre është edhe nënklasa e vetme që i intereson këtij punimi, ajo e emrave që tregojnë “substancë, [si:] dukuri natyrore, *ushqim, shi, borë, breshër, rërë, ujë, tokë, ujë, bukë, gjalpë, kafe, mish, fruta (fruit), makarona*. Nocioni substancë është i dobishëm dhe mund t’i vishet edhe *oksigjenit, nxehësisë, dritës, etj*”. Ndonëse vetëm kjo nënklasë e fundit përbën objektin e këtij studimi, na u desh t’i përmendim shkarazi dhe të tjerat, në mënyrë që lexuesi të formojë një ide nga ç’nënklasa përbëhen emrat e panumërueshëm mëqë gramatikisht sillen si emrat e lëndës.

## 2. Numri i emrave të lëndës

### 2.1 Numri njëjës

Studimi ynë nxjerr se emrat e lëndës përgjithësisht nuk kanë shumë. Luca Serianni tek GI (f. 158), kryen një klasifikim të emrave pa shumë sipas kuptimit, në emra sëmundjesh, muajsh, etj. Emrat e lëndës shfaqen aty këtu: “disa emra elementesh kimike a metalesh (alumini, argjendi, merkuri, ari, bakri, titani, oksigjeni, squfuri)”, “një pjesë e mirë e emrave që lidhen me prodhimet ushqimore (gruri, qumështi, mjalti, buka)”.

“Emra të gjymtë janë ata që nuk kanë njëjës apo shumë. Vetëm në njëjës përdoren [...] emrat e shumë metaleve, mineraleve dhe substancave kimike, *hekuri, qymyri, oksigjeni*; disa emra prodhimesh ushqimore: *kafeja, qumështi, piperi, orizi* [...] të tjerë emra si *gjaku* [...]” (GGSH, f. 43).

“Emrat që kanë vetëm njëjës (*singularia tantum*), përbëjnë shumicën e emrave që emërtojnë sende të panumërueshme: *uthull, sheqer, mendjemadhësi, errësirë, vapë*. Forma e njëjësit këtu s’ka atë kuptim si tek emrat që tregojnë sende të numërueshme” (GGJSH, f. 95).

Më tutje, GGJSH (f. 104) thotë: “Emrat që s’kanë formë shumësi dhe përdoren vetëm në njëjës [janë edhe] emra[t] që tregojnë lëndë në formën e një tërësie të pandashme e të panumërueshme: *benzinë çimento, dhallë, gëlqere, gjizë, kos, rërë, uthull, vaj* etj”.

Edhe BU (f. 661) thotë: “Disa emra janë zakonisht në njëjës. [...] Emrat e lëndëve: ari, argjendi (edhe në kuptimin e fytyruar ‘para’): Të kesh para (‘*argent*’).”

Edhe në anglisht, emrat e panumërueshëm – përfshirë emrat e lëndës - përdoren kryesisht në njëjës. Kjo, siç do ta shohim më tutje, sjell edhe përdorimin e kushtëzuar në njëjës të përcaktorëve a përemrave të pacaktuar (‘this’, ‘that’). Emrat e lëndës kanë këto tipare gramatikore: “1) forma e njëjësit pa një shquese apo joshquese (‘a’, ‘the’): (*Water is necessary for animal and plant life*) *Uji është i nevojshëm për jetën shtazore dhe bimore*. 2) forma e njëjësit e paraprirë nga ‘all’ (‘gjithë’): ‘I say this in all sincerity’ (E them me pastërti). All equipment must be regularly inspected (Tërë pajisjet duhet të kontrollohet sipas rregullit)”. 3) forma e njëjësit të emrit me përemra të pakufishëm *much (shumë), little (pak), a little*

## Emrat e lëndës në gramatika

(pak): There isn't much room in our apartment so we have *little* furniture (*Nuk ka shumë vend në apartamentin tonë, prandaj kemi pak mobilje*)” (EGUC, f. 406-407). Midis shembujve, vetëm i pari, me emrin *ujë* ('water'), tregon substancë. Nevoja për të parë tiparet gramatikore të emrave të lëndës na shtyu të përmendim edhe shembujt e tjerë. Edhe këtu, si më lart, del se tërë emrat e panumërueshëm, përfshirë emrat e lëndës, kanë të njëjtat tipare gramatikore, kjo shpjegon pse gramatika angleze i përdor pa dallim të dy emërtimet. Nga ana tjetër, edhe nga gramatikat e gjuhëve të tjera, midis emrave pa shumës ne shkëputëm vetëm shembujt dhe konstatimet që lidhen me emrat e lëndës.

### 2.2 Numri shumës

Vërtet, emrat e lëndës janë objekt i këtij studimi, por ne do të shohim edhe ata që, duke u përdorur në shumës, shndërrohen nga emra të lëndës në emra të lëndët, për të parë sesi ndryshimi gramatikor (përdorimi i shumësit) sjell ndryshimin kuptimor.

“Emrat e lëndës që kanë vetëm njëjës, në disa raste mund të përdoren në shumës (zakonisht me prapashtesën *-ra*), por me një kuptim të veçantë, që ndryshon nga kuptimi i tyre themelor. Ata emërtojnë atëherë lloje të një lënde ose sende të bëra me të, p.sh.: *djathëra, vajra, verëra; bakëre, hekura*”. (GGJSH, f. 87)

Le t'i shohim veç e veç edhe rastin kur emrat e lëndës në shumës emërtojnë lloje të një lënde, edhe rastin kur ata emërtojnë sende të bëra me to, qoftë tek GGJSH, qoftë gjetkë. “Në shumës mund të përdoren edhe disa emra që tregojnë lëndë por në këtë rast ata fitojnë një element të ri në kuptimin e tyre, marrin domethënien e **llojeve të ndryshme të lëndës**: *vajra, kripëra, djathëra, verëra, miellra*, ose shënojnë një masë të madhe lënde: *ujërat e turbullta të lumit*”. (GGJSH, 95).

Kjo dukuri vihet re edhe në italisht: “Shumësi tek këta emra të gjymtë mund të përcaktojë një ndryshim të ndjeshëm të kuptimit. [M]jalti, orizi dhe emra të tjerë prodhimesh ushqimore shndërrohen në shumës kur flasim për **lloje të veçanta** mjalti, orizi etj. (“i mieli di montagna hanno di solito un sapore più amaro di quelli di pianura” - “mjaltet e malit zakonisht kanë shije më të hidhur se ata të fushës”)” (GI, f. 158).

“Te disa emra metalesh forma e shumësit është larguar nga kuptimi prej asaj të njëjësit dhe duhet marrë si një fjalë e re. Kështu, *argjende, bakëre* emërtojnë **sende të bëra prej lëndës** përkatëse, stoli të argjendta dhe enë prej bakri”. (GGJSH, f. 95)

Për sa i përket frëngjishtes, midis përjashtimeve të emrave që “kryesisht përdoren në njëjës e që në disa raste mund të kenë shumës, me tjetër kuptim” BU (f. 661) jep edhe emra të lëndës. “[...] Hekuri ndryshket (Le fer rouille). *Një tregtar hekurash* (kupto: *hekurishtesh*) (*Un marchand de fers*). *Bëmë përpara midis bronzëve, mermereve* (*Nous avançames parmi les bronzes, les marbres*)”

“*Ari (floriri), argjendi, hekuri*, etj. mund të përdoren në shumës me kuptimin ‘sende të punuara me ar, argjend, etj.’ (“florinjte e aztekëve” - “gli ori degli

aztechi”). Shumësi *hekura* ‘ferri’ tregon ‘veglat dhe pajisjet’: (“veglat e punës (zanatit)” - “i ferri del mestiere”) [...] (GI, f. 158).

“Emri *mish* në formën e shumësit *mishra* merr kuptimin e bagëtive që theren: *Theri dy mishra* d.m.th. desh, shqerra etj. *Agimi po gdhendte një copë dru, duke i dhënë formën e hellit për të pjekur mishra*; ose të pjesëve të trupit prej mishi: *Njeriu ka eshtrat, kyçet, dejtë, mishrat*”. (GGJSH, f. 95)

“Emra që përdoren edhe si të numërueshëm edhe si të panumërueshëm – ca kafe; dy kafe ((some) coffee; two coffees). Shumë emra lënde mund të interpretohen si të numërueshëm, kur u referohen njërive të shkëputura prej referentit lëndë, të cilat konceptohen si sasi marrëveshësore të ushqimit a të pijes. Krahaso: Lëndë: Kafeja dhe çaji ju ndihmojnë të rriini zgjuar. Të numërueshëm: Dy kafe, ju lutem, dhe tre çaj. Kur flitet për gjellëtari restorantesh a avionësh, edhe emra lënde si *mish lope* (*beef*) dhe pulë (*chicken*) mund të interpretohen si racione apo porosi e të kthehen në të numërueshëm. *One beef and two chickens, please!* (kupto: *një racion biftek dhe dy racione pulë!*).

Në raste të tjera, rëndësi ka forma. Prodhimet e ngrënshme kur konsiderohen si me formë të caktuar janë të numërueshme (një djathë, një proshutë, një kek, një patate, një vezë, një pulë, një peshk) ndërsa substanca apo mishi i tyre konceptohet si masë: (ca djathë, ca proshutë, ca kek, ca/pak patate, ca vezë, ca pulë, ca peshk). Po kjo ndodh edhe me peshqit: vetë specia është emër i numërueshëm, substanca e tyre është emër lëndë: Ai kapi një salmon. Për darkë patëm salmon. Ka raste kur çiftet njësi - substancë janë të ndryshme, si cow (i numërueshëm) - beef (lëndë), pig – pork, *sheep* (*dele*) – *mutton* (*mish deleje*), *calf* (*viç*) – *veal* (*mish viçi*), *deer* (*drrer*) – venison (*mish drreri*)” (EGUC, f. 409). Dukuria e emërtimit të racioneve apo porosive me emrin e lëndëve nga se përbëhen vërehet edhe në shqipe. Edhe ne themi në restorant “dy djathë”, “një salcë kosi”, “dy patate” (në kuptimin “dy racione patate të skuqura”), “tre kos” etj. Në dallim nga anglishtja, këta *emra të lëndët* që emërtojnë racione nuk përdoren në shumës. Gramatika shqipe nuk ndalet në këtë dukuri, me përjashtim, siç do ta shohim më poshtë, të një shënimi për rastet kur emrat e lëndës shoqërohen me numërorin *një* (*një duhan, një birra*). Sidoqoftë, e pamë: ajo ndalet në dukuritë ku emri i lëndës, duke u përdorur në shumës, emërton lloje të një lëndë (*vajra, verëra*) ose sende të bëra me të (*argjende*). Nga ana tjetër, as gramatika angleze nuk e përmend dukurinë e emërtimit të llojeve të një lëndë ose të sendeve të bëra me të, ndonëse vërehet dendur në atë gjuhë. Shënojmë gjithashtu se dukuria që vështrimi si formë nënkupton *emër të numërueshëm* (të lëndët) ndërsa vështrimi si substancë nënkupton *emër lëndë* qëndron në tërë gjuhët që shqyrtoam. Së fundi, çiftet njësi – substancë në frëngjisht, ndryshe nga anglishtja, përgjithësisht janë me shenjues të njëjtë (*boeuf – du boeuf, mouton – du mouton*). Po kështu dhe në shqip: *hëngrap pulë, hëngrëm peshk, e fshiva me gazetë*, por më së shumti parapëlqen togjet *mish derri, mish viçi*; sidoqoftë asnjëherë nuk formon çifte të ndryshme si në anglisht.

### 3. Fjalë që shkojnë me emrat e lëndës

#### 3.1 Nya përpjesore në frëngjisht dhe italisht

## Emrat e lëndës në gramatika

“Substancën mund ta konsiderojmë jo më nga pikëpamja e numrit por nga pikëpamja e masës: në këtë rast [sintagmave] ‘un boeuf’ (‘(një) ka’) ose ‘des boeufs’, (‘(ca) qe’), që shënojnë të dyja numrin, u kundërvihet ‘du boeuf’ (‘mish lope/kau’), që shënon masën. Kjo kundërvënie realizohet me anë të nyjës”. (GLFC, f.170) “Në frëngjishten e re, nyja përpjesore përdoret kur duan të tregojnë një ndarje të një sendi pa formë të caktuar. Uji, ca ujë [...]”. (GLFC, f. 219)

“Nga vlera, nyja përpjesore, nuk është tjetër gjë veçse një nyje joshquese përpara një emri për të treguar se bëhet fjalë për një sasi të pacaktuar të një realieje të panumërueshme (substancë të lëndëta, siç i quajnë Damuret dhe Pishon): Pi verë (Boire du vin). 1. Realje të numërueshme mund të konsiderohen si të panumërueshme: Manger du cheval (= de la viande de cheval – ha mish kali). 2. Ndryshe nga ç’thonë disa gjuhëtarë, nyja përpjesore mund të shoqërojë një kryefjalë të vendosur përpara kallëzuesit: *De la buée s’en élevait* (\*Baltë ngrihej). *Dans chaque cour de ferme, du bois avait été accumulé pour l’hiver* (Në çdo kopsht ferme, \*dru kishin mbledhur për dimër). (BU, f. 745 – 746)

Kur BU (f. 746) krahason njëjën joshquese me njëjën përpjesore, lehtësisht të dallueshme në njëjës, merr disa shembuj me emra lënde në femërore dhe mashkullore paraprirë nga nyja përpjesore: “*Boire du vin, de l’alcool, de l’hydromel* (Pi verë, alkool, hidromel); *Boire de la bière, de l’eau* (Pi birra ujë). *Manger du hareng* (Ha peshk). *Brûler de la houille* (Djeg qymyr)”.

Përdorimi i nyjës përpjesore njëjës (‘de’) në kundërvënie me përdorimin e nyjës së shquar (‘le (l’), la’) apo asaj të pashquarës (‘un, une’) sjell edhe ndryshim kuptimor: “*Je bois de l’eau*” (“Pi ujë”). “Uji shihet nga pikëpamja e ndarjes që mund t’i kryhet një lënde pa formë.” “*Je bois l’eau du pot*” (“Pi ujin e poçes”). Sasia nuk llogaritet; uji përcaktohet nga plotësi [e poçes]” “*Kam pirë një ujë të shpifur*” “flitet për një lloj të caktuar uji”. (GLFC, f. 219) Kësaj kundërvënijeje, siç pamë nga përkthimi, në shqip i përkon kundërvënia *i pashquar ≠ i shquar ≠ një + i pashquar*. Më poshtë do të shohim se për emrat e lëndës është karakteristike përdorimi i tyre në trajtën joshquese. Ndërsa në kapitujt e mëposhtëm do të shohim se nyja joshquese *një* ose përdoret për një rast analog me shembullin e fundit (“një ujë si ky të kënaq”), ose përdoret me emrat e lëndët (“një kafe, një kos”).

“Nga prirja për simetri, ka dalë [nyja përpjesore] *des* shumës i *du* dhe *de la*. *Des* mund të nyjëtojë tërë emrat duke shënuar një sasi [ose numër] të pacaktuar ‘des eaux merveilleuses’ (‘[ca] ujëra të mrekullueshëm’). (GLFC, f. 219)

Edhe BU (f. 746) flet për shumësin e parafjalës së nyjshme të njëjtë nga forma me nyjën përpjesore (des [de] ou [dɛ], në lidhëzim [dez] apo [dez] ndonjëherë [de]). Këtu po përmendim vetëm pak shembujt e kësaj të fundit me emra lënde në shumës: “Mund të themi se *des* ka vlerë përpjesore me disa emra që nuk kanë njëjës (§ 508, a): depozitohet arkiva (déposer des archives), manger des rillettes (të hash *rillettes*: mish i grirë i gatuar me sallo); dhe me disa emra që përdoren edhe në njëjës edhe në shumës: renverser des cendres (të derdhësh hi)”.

“Kur emri prihet nga një epitete [...]nyja përpjesore] *de* takohet ende në gjuhën e shkruar, por *du, de la, de l’* përdoren dendur. *De: Je buvais de bonne bière* (Pija

*birrë të mirë*). *J'ai le plus grand plaisir, dit-il, à jouer de bonne musique (Kam kënaqësinë e madhe të luaj muzikë të mirë). Cela fait de bonne viande de boucherie (Është mish i mirë për thertore). Nous enrignons de voir de si bonne poudre se perdre en de longs feux (Tërboheshim kur shihnim si shpërdorohej ky barut kaq i mirë në dyluftime të gjata). C'est de bon bois (Është dru i mirë).*

Format e plota (*du, de la, de l'*): C'est bien bon, du bon vin !... (Oh, vërtet e mirë, verë e mirë) L'enfant Jésus étalé sur de la paille, de la vraie paille (Jezusi fëmijë shtrirë mbi kashtë, mbi kashtë prej vërteti). Un jardin d'été [...], où on entendrait de la très bonne musique (Një kopsht vere [...] ku dëgjohej muzikë shumë e mirë)". (BU, f. 748)

"[Në italisht] nija përpjesore përdoret për të treguar një pjesë të pacaktuar të një të tërë dhe për të formuar shumësin e njëjës joshquese. Merr formën e parafjalës së nyjshme (di + nyje të shquara)" (GE, f. 26). Në një tabelë, po aty, klasifikohen nyjet përpjesore sipas gjinisë dhe numrit (del, dello, dell', dei, degli, della, delle) që siç pamë janë formalisht të njëjta me parafjalët e nyjshme.

Kështu, GE (f. 174), kur flet për parafjalët e "mirëfillta", na vë në alarm që të mos ngatërrojmë parafjalën *di* dhe parafjalët e nyjshme të përbëra prej saj me njëjën përpjesore. Si shembuj merr një rast me parafjalë (*Vorrei un paio di guanti nuovi*) dhe një rast me nyje përpjesore që përdoret me emrin e lëndës *bukë* (*Ricordati di comprare del pane per la cena*).

(GE f. 27). "Nuk ka rregulla të caktuara për përdorimin e njëjës përpjesore; shpesh sqarohet me pranëvënien e një *mbiemri të pacaktuar* (shqipja e quan *përemër të pacaktuar*) (*qualche, alcuni, un pò di*), por mund edhe të nënkuptohet: Berrei volentieri **del** vino; *Berrei volentieri un pò di* vino; Berrei volentieri vino (Do të pija me kënaqësi verë, pak verë, verë)". Në të vërtetë, ndryshe nga frëngjishtja, italishtja nuk e ka të domosdoshme njëjën përpjesore. Përkundrazi, puristët këshillojnë të mos përdoret, si në shembullin e tretë. Ata ndryshe e quajnë *nyje frënge*.

Meqenëse shqipja është gjuhë sintetike, dukuria e njëjës përpjesore, aty përkthehet me pashquarësinë e emrit të lëndës. Kjo u zbulua edhe kur përkthyem shembujt nga frëngjishtja e italishtja. Ja si e shpjegon GGJSH (f. 88) këtë: "Për sa i përket kategorisë gramatikore të shquarsisë e të pashquarsisë për emrat e lëndës është karakteristike përdorimi i tyre në trajtën joshquese njëjës me një kuptim pjesor, si: *pi ujë, ha mish, pi verë, një gotë ujë, një shishe verë, një kg. gëlqere etj*".

3.2.1 Përdorimi përpara emrit të lëndës i parafjalëve *en* apo *de* (en bois, de bois).

"Parafjala *en* që tregon lëndën. Duhet të themi: "une statue de marbre ou en marbre"? (të dyja rastet përkthehen me rasën rrjedhore: një statujë mermeri) "un vase de porcelaine ou en porcelaine" (vazo porcelani)? Litreja vëren se gramatikanët thonë që parafjala *en* nuk mund të përdoret në këtë kuptim, dhe se është gabim të thuhet: "Ma tabatière est en écaille" (Kutia ime e duhanit është prej zhgualli), *Cette étoffe est en soie* (Kjo cohë është mëndafshi). Sipas tij duhet parafjala *de*. Litreja shton: "Megjithatë, ç'është e vërteta, përdorimi i parafjalës *en*

## Emrat e lëndës në gramatika

është shumë i dendur”. Në të vërtetë, të dyja përdorimet janë të mundura, madje mbase më shpesh përdoret parafjala *en*. *Vêtement en linges ou en laine* (rrobë pambuku a leshi) [...]. *Une montre en or* (orë ari). Nuk themi *une pipe de terre* (një llullë qeramike), as *de fausses dents d'or* (dhëmbë të rremë ari). Në kuptimin e fytuar, përdoret gjithnjë parafjala *de*: *Une santé, un cœur de pierre* (Shëndet, zemër guri)”. (DDLf, f. 148.)

BU (f. 439 – 440) e trajton edhe më gjerë këtë dukuri: “Për plotësin [e marrëdhënies] që tregon lëndë përdoret parafjala *de*, sipas traditës klasike, ose *en*, përdorim më i vonë, fillimisht i kundërshtuar, por i hyrë në përdorim dhe pranuar nga *Akademia* që më 1992 (ndërsa më 1936 heshtej)”. Si shembuj jepen një mori fjalësh nga letërsia frënge, në fillim kur plotësi që tregon lëndë përdoret me parafjalën *de* e më pas me parafjalën *en*: “*Une cheminée de marbre* [...] (Një vatër mermeri [...]). *Gros sac de cuir noir* (Çantë e madhe lëkure të zezë). *Un magnifique buste en marbre* [...] (Një bust madhështor mermeri [...]) *Comète en fer forgé* (Kometë me hekur të skalitur)”. Pastaj jepen shembuj “ku të dyja parafjalët janë përdorur: *Ma ceinture de daim blanc* [...] et sa boucle en or mat, [...] *ma chemisette en linon bleu lavé à gros plis* (Ripi im prej lëkure dreri [...] me togëz ari pa shkëlqim, [...] këmishëza prej liri të larë blu me pala të mëdha. *De* vetëm përdoret në disa lokucione: *chevaux de bois* (kuaj druri), *pièces d'or* (monedha ari) (realje që i përket së shkuarës), *soldats de plomb* (ushtarë plumbi), etj.; *médaille d'or, d'argent, de bronze*, (medalje ari, argjendi, bronzi) çmime të fituesit, të të dytit dhe të tretit në gara. *De* parapëlqehet në kuptimin e fytuar: *Mon âme de cristal* (Shpirti im prej kristali). *Elle eût attendri un cœur de granit* (Do të kishte zbutur edhe një zemër graniti). — *Une santé de fer* (shëndet hekuri). *Des yeux de velours* (sy kadifeje). *Une peau de satin* (lëkurë atlas). *Un visage de marbre* (fytirë mermeri). *Avoir la gueule de bois* (të kesh gojë druri në kuptimin: më trashet llapa). [...] *Un cœur d'or* (zemër ari – e artë). *L'âge d'or* (epokë ari – e artë). *Une règle d'or* (rregullë e artë). *Un sommeil de plomb* (gjumë plumbi në kuptimin *gjumë i rëndë*). Sidoqoftë, *en or* përdoret rëndom (përveçse në shprehjet frazeologjike): *Un public en or* (Një publik ari – i artë). *Un mari en or* (burrë ari – i artë). *Un rôle en or* (rol ari - i artë). *Autrefois le professorat était un métier en or* (Dikur profesorllëku ishte zanat ari)”.

Siç e pamë më lart, për plotësin e marrëdhënies që shprehet me emër lënde paraprirë nga parafjala *de* ose *en*, shqipja përdor rasën rrjedhore të emrit të lëndës e më rrallë atë gjinore (Hëngra *mish lope*. *Mishi i lopës* i jep shije gjellës). Të dyja këto rase, GGJSH i përmbledh me emërtimin *rasa të zhdrejta*. Ajo nuk ndalet tek kjo veçori morfo-sintaksore kur flet për emrat e lëndës, por e cek kur flet për mbiemrat marrëdhëniorë: “[...] Këta mbiemra për një pjesë të mirë të kuptimit të tyre janë sinonimikë me rasat e zhdrejta të emrave, që përbëjnë temën fjalëformuese të tyre, p.sh.: *shall i leshtë* – *shall (prej) leshi* [...], *rreze diellore* – *rreze dielli* [...], *shtyllë e mermertë* – *shtyllë (prej) mermeri*. Edhe me emrat në rasat e zhdrejta shprehen marrëdhënie midis sendeve. Madje, disa herë këto rase janë të vetmit shprehës të marrëdhënieve, pra, gjuha nuk ka krijuar për këto mbiemrat marrëdhëniorë përkatës, p.sh.: *qumësht lope*, *mish bualli* etj”.

Edhe në anglishte, kjo marrëdhënie lëndore shprehet me rasën gjinore ose morfemën /'s/ që quhet gjinore pronore. “S-ja [me apostrof] përcaktore duhet marrë në një kuptim më të gjerë se ai i termit traditor ‘pronor’. [...] S-ja [me apostrof] përcaktore nga forma është një grup emëror plus një morfemë e rasës gjinore. [...] Gjinorja nuk i shtohet thjesht kokës, por tërë grupit”. (EGUC, f. 425)

EGUC rendit shumë funksione të kësaj s-je përcaktore, midis të cilave zotërim, kallëzues, kryefjalë, metonimi dhe burim. Mirëpo, nuk jep asnjë shembull me emër lënde. Të vetmin shembull, e jep shumë më tutje (EGUC, f. 466), tek një ushtrim ku kërkohet funksioni semantik që realizon togu me ‘s: *cow’s milk* (*qumësht lope*), dhe na drejton që përgjigjen ta gjejmë tek shembujt e sipërcituar (EGUC, f. 425). Kuptohet që rasti i përmendur do klasifikuar tek funksioni *burim*. Për këtë, u siguroam duke parë një tjetër libër universitar, ku thuhet se “*cow’s milk* (*qumësht lope*) mund të perifrazohet *milk from cow* (*qumësht nga lopa*)”<sup>2</sup>. Ne e dimë se parafjala *nga* mban kuptimin e origjinës, burimit, ndaj dhe zgjedhim këtë përgjigje tek ushtrimi i gramatikës.

Edhe OEGE (f. 175) flet për formën pronore të emrave e cila “shpreh pronësi dhe marrëdhënie të tjera”. Pastaj zgjatet edhe tek mënyra sesi formohet kjo me s- në me apostrof (në të shkruar) dhe të gjitha mënyrat e drejta të shënimit të saj në të shkruar kur emri është në shumës në rastin kur mbaron dhe kur nuk mbaron me s. Më tutje, përmend edhe përdorimin e parafjalës *of* për të treguar pronë, me gjithë dallimet kuptimore që kanë të dyja përdorimet. Një shembull i ilustron të dyja përdorimet: “*the twins’ parents: the parents of the twins*”.

BU (f. 430) shpjegon ç’është *pseudo-plotësi*: “nënrenditja gramatikore nuk përkon me nënrenditjen logjike”. Midis shembujve të shumtë jep edhe një me emër lënde: *Boire un verre d’eau* (pi një gotë ujë). Gramatikani frëng e vështron çështjen nga ana strukturore. Sintagmat *une statue de marbre* (një statujë mermeri) = *un verre d’eau* (një gotë ujë) kanë rend të njëjtë fjalësh, por dallimi kuptimor sjell edhe kundërvënien funksionale: *plotës ≠ pseudo plotës*. Gramatika angleze (EGUC) vështron anën kuptimore. Siç do ta shohim, ajo liston *një shishe birra, një pikë ujë, një fuçi naftë, një gotë verë* etj.: vetëm sasia ndryshon, tipari përbërësor i sasisë nuk ndryshon. Qëndron edhe konsiderata frënge edhe ajo angleze; ndryshon vetëm pikëpamja.

Po le t’i kthehem gramatikës frënge. Ca më tutje (BU, f. 431), shpjegohet *plotësi i karakterizimit*. Midis shembujve të ndryshëm, jepet edhe një me emër lënde: “*Une table en chêne* (një tavolinë lisi), *Un verre à eau* (një gotë uji, njëlloj sikur të thonim *një shishe birra*)”. Më poshtë shpjegohet se “kur i mungon përcaktori [përemri dëftor *ce*, nyja shquese *le* etj.] *plotësi i marrëdhënies* shndërrohet në *plotës karakterizimi: la viande de ce cheval ⇒ la viande de cheval*”.

<sup>2</sup> Andrew John Merrison, Aileen Bloomer, Patrick Griffiths, Christopher J. Hall, *Introducing Language in Use: A Course Book*, Routledge Taylor & Francis Group, London and New York: 2014, f. 132. (ISBN: 9780415291798)

## Emrat e lëndës në gramatika

“Zakonisht, nuk e marrin mbaresën e shumësit emrat e lëndës që u pranëvihen emrave, kur mungon parafjala *en* e cila mbetet e nënkuptuar: Des bas nylon (çorape najloni). *Des robes pure laine, laine et coton (fustane lesh safi, leshi dhe pambuku)*”. (BU, f. 725)

“Emri ‘*plastique*’, edhe e merr edhe nuk e merr mbaresën e shumësit: ‘*des sacs plastiques*’ ‘*des sacs plastique*’ (qese plastike)”. (BU, f. 725)

3.3. Tek BU (f. 803 – 805) flitet për ndajfoljet e *shkallës* si *përcaktorët e pacaktuar* (që në shqip më së shumti përkohet me përemra të pakufishëm (të pacaktuar)) e listohen shumë syresh (*aucun, certain, chaque, différents, divers, maint, nul, plusieurs, quelque, tel, tout, je ne sais quel*). Midis shembujve të shumtë asnjë nuk shfaqet pranë një emri lënde.

Tek BU (f. 803-807), kur flitet për ndajfolje sasiore dhe shprehje ndajfoljore të shkallës në funksionin e përcaktorëve të pacaktuar (të cilët në shqip përkohet me *përemra të pacaktuar* ose ndryshe të *pakufishëm*) midis shumë e shumë shembujsh me emra abstraktë e të numërueshëm, jepen edhe ca shembuj të paktë emra të lëndës: “*Les œuvres les plus belles sont celles où il y a le moins de matière (Veprat më të bukura janë ato ku ka më pak lëndë)*”. Ndonëse *lëndë* është përdorur në kuptimin e fytyruar, si term i poetikës, shembulli siguron se përdorimi vlen edhe në kuptimin e përpamë. Kur flet për shprehjen ndajfoljore *un peu de*, e cila si rregull shkon thajse gjithnjë me emra në njëjës, nuk jep kurrfarë shembulli të kësaj rregulle qoftë me emër lënde qoftë me tjetër emër të panumërueshëm. Përkundrazi, zgjatet tek përyshkrimi i kësaj rregulle me shembuj ku lokucioni ndajfoljor përdoret me emra të numërueshëm. Pastaj, listohen edhe shprehjet e tjera ndajfoljore. Ne kemi shkëputur vetëm shembujt me emra lënde: “*Je vais faire l'impossible pour vous faire parvenir quelque peu de chocolat. (Do të bëj ç'është e mundur për t'ju sjellë ca çokollatë). [...lui], dans l'ensemble, gagne assez d'argent (po t'ia bësh hesapin, ai fiton mjaft para). Donnez davantage de lumière. (Sillni edhe më dritë). Il a tant ou tellement d'argent qu'il ne sait qu'en faire (Ka aq shumë para sa s'di ç'të bëjë me to). J'ai trop bu de vin*”. Shprehja *bien du, de la, de l'*, nuk përdoret me emra konkretë, ndaj, shembulli me emrin e lëndës *verë*: “*Elle a bu bien du vin (ajo ka pirë mjaft verë)*” jepet vetëm për të vërejtur se nuk është i natyrshëm. Vërtet shkëputëm vetëm shembuj të përdorimit të shprehjeve ndajfoljore (me funksionin e përemrave të pacaktuar) me emra lëndës. Por krahas tyre kishte shembuj të shumtë me emra të numërueshëm. Kjo dëshmon se shprehjet ndajfoljore përdoren pa dallim edhe me emra të numërueshëm edhe emra të lëndës a të tjerë të panumërueshëm. E njëjta, me ndonjë përyshkrim, mund të thuhet, për *përcaktorët e pacaktuar* (*përemrat e pacaktuar*) që kjo gramatikë (BU) listonte më lart, ndonëse këtë nuk e pamë as të shprehur shkoqur në ndonjë përkufizim, e as në shembuj.

“Meqenëse tregojnë një masë lënde që, megjithëse nuk mund të emërohet, mund të matet e të peshohet, emrat e lëndës kanë mundësi të përcaktohen nga fjalë që tregojnë një sasi të pacaktuar, si *shumë, pak, ca: ca qymyr, pak djathë, ca duhan, pak benzinë etj*”. (GGJSH, 1. 87)

Pohimin e mësipërm, GGJSH-ja e bën kur flet enkas për emrat e lëndës. Ndërsa, kur flet për përemrat e pacaktuar, ndonëse i përcakton edhe si “përemra që tregojnë [...] sasi të pacaktuar [sendesh]” (GGJSH, f. 249), nuk jep asnjë shembull kur ata përdoren në këtë funksion, siç do të ishin p.sh. *pak bukë, pak kripë, ca qymyr*. Ne dimë se ka përemra të pacaktuar që përdoren vetëm me emra të numërueshëm (si p.sh. *disa*) e ca të tjerë që përdoren edhe me emra të numërueshëm edhe me emra të panumërueshëm, midis të cilëve dhe me emrat e lëndës (si ata që përmendëm: *pak, ca*), por do të na lehtësonte punë për të dalë në përfundimin se ky përgjithësim, që u pa tek gramatika frënge vlen edhe për shqipen. Pamë dhe më lart (do ta shohim dhe më poshtë) se gramatikat nuk i thonë të gjitha që duhet të thonë për emrat e lëndës: rasti më i skajshëm – por i rëndomtë – është ai i mostrajimit në tituj të posaçëm. Kjo do të na shtyjë paskëtaj të kryejmë një studim më vete se si trajtohen emrat e lëndës në studime të fushës së gramatikës.

Tani, t'i kthehemi asaj që po diskutonim. E pamë se në anglisht, emrat e lëndës, në kuptimin të panumërueshëm (EGUC f. 406 - f. 407), kanë karakteristikë se ndonëse përgjithësisht janë në njëjës, nuk shoqërohen as nga nyja joshquese ('a') as nga nyja shquese ('the'). Ndryshe nga ç'ndodh me emrat e numërueshëm, këtu njëjësi paraprihet nga 'all' ('gjithë'). Përemrat e pakufishëm (e pacaktuar) *much* (shumë), *little* (pak), *a little* përdoren vetëm me emra lënde. Përcaktorët “the, this, that, my, your, his, her, its, our, their” përdoren pa dallim edhe me emra lënde edhe me emra të numërueshëm. Këta përcaktorë dhe përemra janë në njëjës, ngaqë emrat e lëndës janë në njëjës. Këtë e nënvizon edhe OGEG (f. 179): “Një emër lënde përdoret me folje në njëjës dhe me *this/that* dhe *it*”.

“Ka një numër emrash që ngjallin vogëlsi ose formë dhe përdoren për të sugjeruar një sasi minimale substance apo diçkaje jo konkrete. Ata ndiqen nga parafjala *of* dhe nga emri i panumërueshëm, dhe priren të kenë përndarje të veçantë. Këtu kemi disa nga më të rëndomtët, të paraprirë nga nyja joshquese (kemi përfshirë vetëm shembuj me emra të lëndës sipas kuptimit tonë): A bit of paper, cheese, ham, cloth, wood (një grimë letër, djathë, proshutë, cohë, dru). A piece of paper, cheese, meat, chocolate, bread, toast, wood (një copë letër, djathë, mish, çokollatë, bukë, dru). A clove of garlic (vs a head of garlic) (një thelb hudhër, në kundërvënie me një kokë hudhre). A drop of milk, whisk(e)y, sherry, water, blood (një pikë qumësht, uiski, liker, ujë, gjak). A loaf of bread (me kuptimin *një bukë*, por në anglisht, ndryshe nga shqipja, ky rast nuk është emër i lëndët). A pinch of salt (një pisk kripë). A ray of sunshine, light, hope (një rreze dielli, drite, \*shprese). A scrap of paper, cloth, evidence (një copë letër, leckë, \*provë). A slice of bread, ham, cheese, turkey (një fetë bukë, proshutë, djathë, (një fileto) gjel deti). A speck of dust, dirt (often used in the negative not a speck of dust/dirt, etc.). A spoonful of sugar (një lugë sheqer).

[...] Ashtu si këto më lart, enë të ndryshme përdoren për të përcaktuar sasi emrash lënde. A bottle of wine, beer, whisk(e)y, water (një shishe verë, birra, uiski, ujë). A cup/ mug of tea, coffee (një filxhan i vogël / i madh çaji, kafeje). A can of beer, petrol (një kanaçe birra, një bidon naftë). A carton of yogurt, cream,

## Emrat e lëndës në gramatika

custard (një karton kos, krem, krem karamel). A pack of cards, milk, fruit juice, yoghurts (një kuti \*letrash, qumështi, lëngu frutash, kosi). A packet of tea, coffee, biscuits (një pako çaj, kafe, biskota). A tablet of soap, chocolate (një copë sapuni, çokollate). A tin of tomatoes, soup, sardines, biscuits (një kuti (konservë) domatesh, supe, sardelesh, biskotash)". (EGUC, f. 409 - 410)

“Vetëm në raste të caktuara, sidomos në gjuhën e folur, disa emra pijesh ose lëndësh ushqimore mund të përdoren të shoqëruara me numërorin *një*, por me një kuptim të ndryshëm, të veçantë: *më sill një verë, një ujë, një birra* (= një gotë verë, ujë, birra), *një qumësht, një kos, një djathë* (= një gotë qumësht, një tas kos, një copë djathë); *më jep një duhan* (= një cigare duhan). Me kuptimin e lëndës në përgjithësi, pra me kuptim përgjithësues, emrat lëndorë, sidomos kur ka krahasime, mund të shoqërohen nga numërori *një* me vlerën e një përemri të pacaktuar: *Një ujë si ky të kënaq. Një duhan i tillë s'ka të paguar*". (GGJSH, 87)

Siç pamë më lart – kur po shpjegojmë kundërvënien *nyje përpjesore ≠ nyje joshquese* (GLFC, f. 219) – edhe në frëngjishte, njëlloj si në shqipe, përdorimi i emrit të lëndës me nyjën joshquese *një (un)*, ka kuptimin e lëndës në përgjithësi, pra kuptim përgjithësues. Edhe shembulli është i ngjashëm (“*Kam pirë një ujë të shpifur*”, krahaso: *Një ujë si ky të kënaq.*) E tepërt të sqarojmë barazimin, në këtë rast, *nyje joshquese = numërori një*. Vetë GGJSH vëren se numërori *një* ka vlerën e një përemri të pacaktuar.

### 6. Mbiemrat marrëdhëniorë

U ndalëm edhe tek *mbiemrat marrëdhëniorë* nga lidhja që në shumë raste kanë me emrin e lëndës nga vijnë. Kjo lidhje është aspekti ku do të hedhim më shumë dritë, si i vetmi që i intereson këtij punimi.

GGJSH (f. 155) shpjegon klasifikimin e mbiemrave sipas kuptimit: “Duke u nisur nga ajo se çfarë tipari emërtojnë gjithë mbiemrat e gjuhës shqipe mund të ndahen në dy grupe të mëdha: a) [...] mbiemra cilësorë [...] dhe b) mbiemra që tregojnë marrëdhënie, të cilët do të quhen mbiemra marrëdhëniorë [...]”.

“Mbiemrat e marrëdhëniorë bashkë me mbiemrat cilësorë, mund të quhen një nënkategori e veçantë pasi përbëjnë një listë të hapur [në kuptimin që leksiku i tyre pasurohet lehtë]”. (GI, f. 192)

“Mbiemrat marrëdhëniorë e japin tiparin e sendit, emrin e të cilit e karakterizojnë, nëpërmjet emërimit të marrëdhënive të këtij sendi me një send tjetër [...]. Pra, këta mbiemra emërtojnë marrëdhëniet e mësipërme, por këto, i japin si tipare tipike e të qëndrueshme të sendeve. Në këtë vështrim këta mbiemra për një pjesë të mirë të kuptimit të tyre janë sinonimikë me rasat e zhdrejta të emrave, që përbëjnë temën fjalëformuese të tyre, p.sh.: shall i leshtë - shall (prej) leshi [...], rreze diellore - rreze dielli [...], shtyllë e mermertë shtyllë (prej) mermeri. Edhe me emrat në rasat e zhdrejta shprehen marrëdhënie midis sendeve. Madje, disa herë këto rase janë të vetmit shprehës të marrëdhënive, pra, gjuha nuk ka krijuar për këto mbiemrat marrëdhëniorë përkatës, p.sh.: qumësht lope, mish bualli etj. Por këto marrëdhënie emrat e mësipërm nuk i japin gjithmonë si tipare të qëndrueshme të një sendi, por më shpesh si marrëdhënie konkrete, që dalin në raste të veçanta. Te mbiemrat marrëdhëniorë, përkundrazi, marrëdhënia

jepet si një tipar i qëndrueshëm e i abstraktuar, si kuptim kategorial. Pra, ndryshimi themelor i këtyre mbiemrave nga format e zhdrejta rasore të emrave përgjegjës qëndron pikërisht në kuptimin e përgjithshëm kategorial të tiparit; këta mbiemra kanë aftësi më të mëdha përgjithësuese, tipizuese sesa rasat e zhdrejta të emrave”. (GGJSH, f. 156)

BU (f. 431) e vështron çështjen e rasave të zhdrejta nga ana e kundërt dhe vë re se “plotësat e karakterizimit [rasat e zhdrejta] shpesh përkojnë me epitete: *du gibier d'eau, du gibier acquatique (gjah uji, \*gjah ujor)*”, madje vë re edhe se “jo gjithnjë ekziston mbiemri: *du poisson de rivièrë (peshk lumi)*”, rast analog ky me shembullin që dha më lart gramatika shqipe (*mish lope*). Këtyre u shton edhe rrethanën se “disa mbiemra kanë përdorim të kufizuar: themi *une algue marine (\*algë detare, në kuptimin algë deti)* por jo *\*du poisson marin (\*peshk detar, në kuptimin peshk deti)*”.

Konstatimet e gramatikës shqipe i bën pak a shumë edhe gramatika italiane. “Mbiemrat marrëdhëniorë janë prejmemërorë që kanë vetinë të shprehin një marrëdhënie të qëndrueshme me emrin nga vinë, duke sjellë përmbajtjet kuptimore në një kategori të ndryshme (me fjalë të tjera, një mbiemër marrëdhënior e sjell një emër në formën e një përcaktori mbiemëror). (GI, f. 192)

“[Disa] mbiemra marrëdhëniorë janë të prejardhur nga emra që emërtojnë lëndë”. GGJSH (f. 158) Mbiemri marrëdhënior mund të shprehë: [...] *një marrëdhënie lëndore, d.m.th. ta përcaktojë sendin e dhënë për nga lënda prej së cilës ai përbëhet: rreth i artë, kullë e gurtë, derë e hekurt, fustan i mëndafshhtë, bluzë e pambuktë* etj. [...]. Pra, në mbiemrat marrëdhëniorë bëjnë pjesë mbiemrat lëndorë [...].”

“Mbiemrat marrëdhëniorë nuk e kanë kategorinë e shkallës”. (GGJSH, f. 158)

Edhe gramatika italiane (GI, f.194) pohon se mbiemri marrëdhënior nuk e ka kategorinë e shkallës dhe jep një shembull me mbiemër të lënde: (*calore*) *solare (nxehësi diellore)*. [Mirëpo], kur mbiemrat marrëdhëniorë (lëndorë) përdoren me funksion cilësor mund të ndryshojnë shkallë.

*Funksionin cilësor* e përmend edhe gramatika e shqipes: “Mbiemrat marrëdhëniorë kalojnë lehtë në mbiemra cilësorë, përgjithësisht kur përdoren me kuptim të fytyruar (të figurshëm). Pikërisht në sajë të kuptimit të temës prodhuese të mbiemrave marrëdhëniorë, të polisemisë së saj, bëhet e mundshme që këta mbiemra, në përdorime të caktuara, të emërtojnë një tipar cilësor, kurse emërtimi i marrëdhënies të kalojë në plan të dytë. Pra, në plan të parë, në këto raste del emërtimi i karakteristikës cilësore të sendeve [...]. Një gjë e tillë nuk ndodh menjëherë e drejtpërsëdrejti. Këta mbiemra në fillim pasurojnë rrethin e kuptimeve të tyre me një semantikë të re cilësore. Kjo polisemi e mbiemrave bëhet e mundshme pikërisht në sajë të polisemisë së emrave që qëndrojnë në bazë të tyre. Cilësia që emërton mbiemri i dhënë, është e sendit, nga emri i të cilit formohet mbiemri, dhe është pikërisht kjo veti që bën të mundshëm përdorimin e fytyruar të mbiemrit të dhënë, d.m.th. përdorimin e tij si mbiemër cilësor. Kjo është edhe arsyeja pse nuk mund të zhvillojë kuptime cilësore çdo mbiemër. Kështu, po të marrim parasysh numrin e madh të mbiemrave marrëdhëniorë, del se

## Emrat e lëndës në gramatika

vetëm një numër diku i vogël kanë fituar aftësinë të emërtojnë tipare cilësore. P.sh.: *Lëndina dukej e larë nga rrezet e arta të diellit pranveror. Si shumë i lehtë kërkon të shitesh, i pandehur. Shoku i tij kishte një vullnet të çeliktë*. Emri i karakterizuar dhe konteksti ndihmojnë për të marrë vesh nëse mbiemri është përdorur në kuptimin e tij të parë, apo në kuptimin e fyturuar. Kështu, p.sh., mbiemri *i artë* mund të ketë këto kuptime cilësore: 1) i ngjashëm me arin për nga ngjyra: *flokë të artë, kaçurrela të artë, vjeshtë e artë, rreze të arta* etj.; 2) shumë i mirë, i mrekullueshëm: *njeri i artë, zemër e artë, fjalë të arta, mot i artë* etj.; 3) i lumtur, i bukur: *kohë e artë, ditët e arta të rinisë* etj”. (GGJSH, f. 157)

Ndonëse tërthorazi, gramatika e shqipes pohon se emrat lëndorë kanë një polisemi, që ua trashëgojnë mbiemrave; dhe se kanë një përdorim të fyturuar që “bën të mundshëm përdorimin e fyturuar të mbiemrave [të ardhur prej tyre]”. Ç’është e vërteta, edhe emrat e lëndës “e pasurojnë rrethin e kuptimeve të tyre me një semantikë të re”, por kjo nuk shfaqet në gramatikat që studiuam. Këtë na duhet ose ta kërkojmë në studime të semantikës leksikore ose të synojmë ta nxjerrim vetë me anë të analizës përbërëse.

GI (f. 192) bën inventarin e prapashtesave të mbiemrave marrëdhëniorë. Midis shembujve që jepen, vetëm dy mbiemra vinë nga emrat e lëndëve, dhe kanë prapashtesën *-oso [-ozo]*: *ferro – ferroso* (hekur – i hekurt), *fumo – fumoso* (tym – i tymtë). As më tutje, (f. 193) nuk flitet për mbiemra lëndorë, përveçse ka shembuj të paktë. “*Legno – legnoso* (“*dru – i drunjtë*”) për të ilustruar rastin kur mbiemrit marrëdhënior (në rastin tonë *lëndor*) i kuptohet lehtësisht prejardhja. Për të ilustruar të kundërtën, kur mbiemri marrëdhënior ka ardhur nga një emër në latinisht apo greqisht të vjetër, jepen gjithashtu ca shembuj me të prejardhur nga emra lënde: *caseario* “del formaggio” (nga latinishtja “djathë”), *eburneo* – “d’avorio” (“i fildishtë” nga latinishtja), *ittico* – “del pesce” (nga greqishtja *peshk*), *cardiaco* (kardiak) – “del cuore” (nga latinishtja “zemër”).

Më tej (f.194), GI sqaron se prapashtesa të njëjta ose të ndryshme mbiemrash marrëdhëniorë mund të kenë kuptime aq të ndryshme saqë nuk ia vlen t’i ndash në grupe. Midis ilustrimeve është edhe mbiemri lëndor *ferro – ferroso* (*hekur – i hekurt*), i cili në kundërvënien me mbiemra të tjerë me prapashtesë të njëjtë a të ndryshme, ka tjetër lidhje semantike me emrin nga rrjedh.

“[Në frëngjisht, prapashtesat] **-in, -ine** [nga lat. -inum, -inam] mund të formojnë mbiemra [...] nga emra. [...] Kjo prapashtesë shënon [ndër të tjera] një marrëdhënie lënde [si] *argentin* (prej argjendi)”. (BU, f. 175)

### Përfundime

Nga mënyra sesi përkapet mendërisht një referent, si njësi e ndarë e numërueshme, apo si njësi e pandashme e panumërueshme mase lëndore, emrat përkatës ndahen në të numërueshëm dhe të panumërueshëm. Emrat e lëndës bëjnë pjesë në këta të fundit. Këtyre, po t’u kryejmë një ndarje sipas kuptimit, emrat e lëndës bëjnë pjesë në nënklasën e emrave që tregojnë substancë. E thënë ndryshe, ata janë fjalë që emërtojnë një lëndë homogjene, që mund të ndahet në pjesë dhe të peshohet, por që nuk mund të numërohet. Nga kuptimi i tyre leksikor emrat e lëndës janë fjalë të ndryshme, që emërtojnë: prodhime ushqimore, kultura

bujqësore, metale e minerale, kimike etj. Disa gramatika i përmendin me termin *emra të lëndës* apo *të lëndëve*. Njëlloj si gramatikat angleze, Larousse i quan *emra të masës* apo *që tregojnë masë*. Disa të tjera nuk i përmendin fare, por nëngrupe të tyre shfaqen aty këtu; të tjera shfaqin emërtime më të ngushta, si emra elementesh kimike a metalesh, emra që lidhen me prodhimet ushqimore, emra që tregojnë substancë. Vetëm dy nga tetë gramatikat që studiuam u kushtojnë pjesë të posaçme emrave të lëndës. Emrat e lëndës trajtohen më së shumti në kapitujt e morfologjisë, në ata kapituj që u kushtohen pjesëve të ligjëratës, ndonëse aty këtu shfaqen edhe në pjesët e sintaksës.

Në gramatikën angleze, përdoret termi emër ‘i panumërueshëm’ dhe ‘emër lënde’ pa dallim, ndonëse se hartuesit e saj janë të vetëdijshëm se nga pikëpamja kuptimorë emri i panumërueshëm nuk është domosdoshmërisht emër lënde, pasi jo të gjithë emrat e panumërueshëm janë emra lënde. Në të vërtetë, emrat e lëndës kanë tiparet gramatikore të tërë klasës e emrave të panumërueshëm.

Emrat e lëndës përgjithësisht nuk kanë shumës. Kur përdoren në shumës, emrat e lëndës marrin një kuptim të veçantë, që ndryshon nga kuptimi i tyre themelor. Ata emërtojnë atëherë lloje të një lënde, sende të bëra me të, ose një masë të madhe lënde. Një rast i ndryshëm nga këto është emri *mish*, *i cili*, në formën e shumësit *mishra*, merr kuptimin e bagëtive që theren. Shumësi i emrave të lëndës mund edhe të emërtojë racionet apo porositë. **Vështrimi** si formë nënkupton *emër të numërueshëm (të lëndët)* ndërsa vështrimi si substancë nënkupton *emër lënde* qëndron në tërë gjuhët që shqyrtoam. Çiftet njësi – substancë në frëngjisht, ndryshe nga anglishtja, përgjithësisht janë me shenjues të njëjtë. Po kështu dhe në shqip. Ndryshe nga anglishtja, në shqip, këto *emra të lëndët* që emërtojnë racione nuk e marrin mbaresën e shumësit.

Midis fjalëve që shkojnë me emrat e lëndës në frëngjisht dhe në italisht është *nyja përpjesore*. Nga vlera, *nyja përpjesore*, nuk është tjetër gjë veçse një *nyje* joshquese përpara një emri për të treguar se bëhet fjalë për një sasi të pacaktuar të një realieje të panumërueshme. Ndryshe nga frëngjishtja dhe italishtja, si gjuhë më shumë sintetike se analitike, shqipja nuk e ka *nyjen përpjesore*, por vendos emrin e lëndës në të pashquar. Ndërsa, *nyja* e shquar dhe ajo joshquese përkthehen përkatësisht me shquarsinë dhe pashquarsinë e emrit. Për të treguar marrëdhënie lëndore midis dy emrave, frëngjishtja përdor parafjalët *de* dhe *en*, ndërsa shqipja rasat e zhdrejta, e më konkretisht, në rasën rrjedhore me ose pa parafjalën *prej* dhe rasën gjinore. Edhe anglishtja, këtë marrëdhënie lëndore e shpreh me rasën gjinore ose morfemën /‘s/ që quhet gjinore pronore. Po ashtu ajo përdor edhe parafjalë *of* për të treguar pronë. Meqenëse tregojnë një masë lënde që, megjithëse nuk mund të emërohet, mund të matet e të peshohet, emrat e lëndës kanë mundësi të përcaktohen nga fjalë që tregojnë një sasi të pacaktuar. Në frëngjisht, ndajfoljet e sasisë dhe përemrat e pacaktuar përdoren pa dallim edhe me emra të numërueshëm edhe emra të tjerë. Kjo vlen edhe për shqipen ndonëse nuk e pamë të shprehur shkoqur në ndonjë përkufizim a të ilustruar me shembuj. Emrat e lëndës, në anglisht, ndonëse përgjithësisht janë në njëjës, nuk shoqërohen as nga *nyja* shquese as nga *nyja* joshquese. Ndryshe nga ç’ndodh me emrat e numërueshëm,

## Emrat e lëndës në gramatika

---

këtu njëjësi mund paraprihet nga 'all' ('gjithë'). Në anglisht, disa përemra të pacaktuar përdoren vetëm me emra lënde. Ndërsa, përemrat dëftorë dhe pronorë përdoren pa dallim edhe me emra lënde edhe me emra të numërueshëm. Sidoqoftë, e përbashkët është se një pjesë e madhe e parafjalëve që shkojnë me emrat e lëndës, shkojnë edhe me emrat e numërueshëm.

Mbiemri marrëdhënior mund të shprehë: *një marrëdhënie lëndore*, d.m.th. ta përcaktojë sendin e dhënë për nga lënda prej së cilës ai përbëhet, dhe quhet mbiemër lëndor. Mbiemri lëndor nuk e ka kategorinë e shkallës. Mbiemrat marrëdhëniorë, njëjloj si mbiemrat cilësorë, përbëjnë një listë të hapur.

Për emrat e lëndës mund të bëhen përgjithësime që vlejné për të gjitha gjuhët. Sidoqoftë, ka edhe veçori gramatikore të tyre që ndryshojné nga gjuha në gjuhë që mund të lidhet me atë nëse gjuha është sintetike apo analitike. Vendi ku shfaqen emrat e lëndës në gramatika është në varësi të tipareve gramatikore në secilën gjuhë. Disa rregulla shpjegohen qartë në gramatika, disa rregulla nxirren nga shembujt, ndërsa disa të tjera heshten. Këto të fundit mund t'i nxjerrim nga studimi i gramatikave të tjera, qofshin të së njëjtës gjuhë apo të gjuhëve të tjera. Kështu, gramatikat nuk i thonë të gjitha që duhet të thonë për emrat e lëndës: rasti më i skajshëm por i rëndomtë është ai i mostrajtitimit në tituj të posaçëm. Kjo do të na shtyjë të kryejmë një studim më vete se si trajtohen emrat e lëndës në studime të fushës së gramatikës.

### BIBLIOGRAFI

- A. V. Thomas, *Dictionnaire des difficultes de la langue française*, Librairie Larousse, Paris VI, 16e tirage, edition 1969.
- A. Alberti, *Grammatica essenziale*, Antonio Vallardi Editore s.r.l., Milano, 1996.
- A. J. Merrison, A. Bloomer, P. Griffiths, C. J. Hall, *Introducing Language in Use: A Course Book*, Routledge Taylor & Francis Group, London and New York: 2014. (ISBN: 9780415291798)
- A. Downing, P. Locke, *English Grammar, A University Course*, Routledge (Taylor & Francis Group), London and New York, Botim i dytë, 2006.
- F. Agalliu etj., *Gramatika e gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave, Vëllimi 1: Morfologjia, Tiranë, 2002.
- J. C. Chevalier, C. B. Benveniste, M. Arrivé, J. Peytard, *Grammaire Larousse du français contemporain*, Librairie Larousse, Paris, edition 1972.
- J. Eastwood, *Oxford Guide to English Grammar*, Oxford University Press, Walton Street, Oxford, 0x2 6DP, botimi i shtatë, 2012. (ISBN: 0 19 431351 4)
- L. Serianni, *Grammatica italiana – italiano comune e lingua letteraria*, De Agostini Scuola SpA, Novara, 2010.
- M. Grevisse, A. Goosse, *le Bon Usage*, Grammaire, langue française, De Boeck - Duculot, Paris-Louvain-la-Neuve, botim i katërbëdhjetë, 2007.

